



Prishtinë: 19.12.2008.

Kodi i ZRRE-së: V\_149\_2008

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_R\_110\_08\_08

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_R\_110\_08\_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2008 nxori këtë:**

### VENDIM

**PRANOHET pjesërisht** ankesa e konsumatorit Avni Humolli N.T.P “Euro – Market” (shifra e konsumatorit DPR - 90043290) nga Besiana, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të datës 19.02.2008 ka apeluar përgjigjen e Departamentit për Konsumatorë në KEK të datës 21.01.2008, lidhur me ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 31.08.2007, ekipi i KEK-ut ka dalë në vendin e ngjarjes tek konsumatori dhe ka përpiluar procesverbalin nr. 003063 në të cilin është theksuar se konsumatori furnizohet me energji elektrike jashtë pikës matëse.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 003063 të datës 31.08.2007.
- Me datë 15.09.2007, KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me një ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar nëpërmjet faturës DPR07HP03733 në shumë prej 2,309.84 €. **Provë:** Fatura e KEK-ut DPR07HP03733 e datës 15.09.2007
- Me datë 21.11.2007, konsumatori ka parashtruar ankesë në departamentin për konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.
- Me datë 21.11.2007, departamenti për konsumatorë në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesin e kontrollës nr. 003063.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 14.12.2007
- Me datë 19.12.2007, konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut dhe konsumatorit, ka vërejtur se:

- ✓ Konsumatori deklaron se në momentin e inspektimit nga punëtorët e KEK-ut, frigoriferët kanë qenë të furnizuar nga furnizimi i shtëpisë; pra energjinë e shpenzuar e ka regjistruar njehsori i



shtëpisë, ky veprim sipas konsumatorit është bërë për shkak të ngarkesës shumë të madhe në lokal.

- ✓ Në datën e përpilimit të procesit nga ekipi i kontrollit të KEK-ut 31.08.2007, njehsori i shtëpisë së vëllait të konsumatorit nr. 12311932, për të cilin konsumatori deklaron se në te kanë qenë të lidhur frigoriferët, nuk ka qenë i regjistruar në KEK.
- ✓ Konsumatori ka bërë kërkesë për regjistrimin dhe bllobimin e njehsorit nr.12311932 në KEK me datë 04.09.2007 (4 ditë pas inspektimit të pikës matëse nga ana e ekipit të kontrollit).  
**Provë:** Kërkesa e konsumatorit në KEK e datës 04.09.2007.
- ✓ KEK-u e ka regjistruar njehsorin nr. 12311932 në CCP me datë 21.12.2007  
**Provë:** Transaksionet e konsumatorit – shërbimet.
- ✓ Sipas deklaratës së lexuesit të KEK-ut theksohet se deri në muajin 06/2007 frigoriferët kanë qenë në matje tek njehsori elektrik i lokalit, ndërsa pas këtij muaji ky lexues i KEK-ut nuk e ka bërë leximin e atij rajoni.  
**Provë:** Deklarata e lexuesit të KEK-ut.
- ✓ Edhe pse lexuesi ka dhënë deklaratë me shkrim se frigoriferët e konsumatorit kanë qenë të lidhur në njehsorin e lokalit, kjo deklaratë nuk mund të merret si shumë e besueshme, ngase nuk është detyrë e lexuesit që të shikoi se cilat pajisje janë të lidhura në njehsorin të cilin e lexon.
- ✓ Sipas procesverbalit nr. 003063 të ekipit të kontrollës së KEK-ut vërehet se disa frigoriferë të konsumatori furnizohen me energji elektrike e cila nuk regjistrohet në njehsorin e lokalit, për shkak të këtij veprimi KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.  
**Provë:** Procesverbali nr. 003063 i datës 31.08.2007.
- ✓ Ekipet e kontrollit të KEK-ut nuk kanë shënuar se ku janë të kyçur frigoriferët dhe dritat, por vetëm ka shënuar se këto pajisje nuk janë përmes njehsorit të lokalit.
- ✓ Fatura e KEK-ut për shfrytëzim të paautorizuar DPR07HP03733 në shumë prej 2,309.84 ka përfshirë një periudhë prej 24 muaj mbrapa.  
**Provë:** Fatura e KEK DPR07HP03733 dhe deklarata e lexuesit.
- ✓ Fatura e parë për këtë pikë matëse DPR 90043290 është për muajin e 10/2006 andaj llogaritja e konsumit të paautorizuar për 24 muaj është e gabuar.

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmive të paraqitura rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **pranojë pjesërisht** ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **pranojë pjesërisht** ankesën për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK, dhe atë vetëm sa i përket kohëzgjatjes së llogaritjes së konsumit të paautorizuar të energjisë së llogaritur nga KEK-u.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Ta shkarkojë konsumatorin nga fatura e ngarkesës për shfrytëzim të paautorizuar DPR07HP03733 për shkak se kalkulimi është bërë për 24 muaj.
2. KEK-u obligohet ta ngarkojë konsumatorin me ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar në bazë të procesverbalit nr. 003063 për periudhën prej datës së përpilimit të procesit deri në muajin e 10/2006.



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar